





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government


22.02.2017

[Signature]

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	15.02.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 41/2
PËR/ZA/TO:	Alban Bakija, Drejtor i IKMM-së Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Ankesë



Po Ju dërgojmë ankesën e Jeton Hisarit për refuzimin e kërkesës për ndërtimin e shtëpisë në ngastrën kadatrale nr.3092-2.



109

15. 03. 2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of
Monuments / Institut Kosova za Zastitu Spomenika

DATE/A:	09.03.2017
REFERENC-Ë:	04/2017 – Takimi i katërt
PËR/ZA/TO:	Z. Agim GËRGURI – U.D. Drejtor i Instituit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
CC:	Z. Bislim BISLIMI – Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL – MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; Znj. Zana LLONÇARI OSMANI – Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore – MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Teuta SELMANAJ – Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit.
NGA/OD/FROM:	Znj. Merita AUGUSTINI NRECAJ – Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren dhe Pejë.

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376 ka zhvilluar takimin e tretë (3) punues me datë 24.02.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) – Prizren dhe Pejë. Janë dhënë rekomandimet si në vijm:

Rreth kërkesës Nr. 3. QRTK – Prizren:

3. Lënda e titulluar “Ankesa lidhur me refuzimin e dhënies së pëlqimit për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim me lokal afarist B+P+2, në ngastrën kadastrale me Nr. 3092 – 2, me pronar Jeton Hisari”, gjendet në rrugën “Shuajb Spahiu” është trajtuar gjerësisht nga ana e Komisionit. Kjo materie është trajtuar si “kërkesë për rishqyrtim” pasi gabimisht është emërtuar si “ankesë”, duke ditur se IKMM në këtë fazë të procedurës administrative nuk vepron si organ i ankesës për vendimet e veta por mund të veprojë si organ që trajton kërkesën për rishqyrtim të aktit administrativ. Objekti ekzistues në ngastrën që parashihej të ndërtohet, gjendet në shtojcën e II – të të Ligjit nr. 04/L – 066 për Qendrën Historike të Prizreni, si Objektet e Banimit me Nr. rendor 43 (shtëpia e Hilmi Hisarit).

Pala përfaqësuar nga Jeton Hisari, Kundër Aktvendimit të Komunës së Prizrenit – Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor 04-353-181530, të datës 20.01.2017, në afat ligjor parashtron këtë:

Ankesë

- Përshkak të shkeljeve themelore të dispozitave procedurale,
- Vërtëtimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- Zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Komisioni rikujton se veprimtaritë e lejuara në këtë ngastër përfshijnë vetëm aktivitetet konservuese - restauruese.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës,

Rekomandon:

1. Komisioni qëndron prapa shqyrtimit, vlerësimit dhe rekomandimit paraprak për këtë lëndë dhe përsëri të njëjtin vlerësim i rekomandon Drejtorit të IKMM –së i cili vendos përfundimisht;
2. Ndërtesa në ngastrën kadastrale me nr. 3092-2 ku parashihej të ndërtohet gjendet në shtojcën e ligjit, pra e mbrojtur me ligj dhe veprimtaritë e lejuara në këtë ngastër janë mirëmbajtja, përf forcimi i strukturës dhe konservimi e restaurimi.

Rreth kërkesës Nr. 4. QRTK – Prizren:

4. Ndërtesa Xhamia e fshatit është ndërtuar në anën e djathtë të rrugës Krushë e madhe – Rahovec, mbi një breg që dominon mbi këtë fshat. Xhamia është e shekullit XV dhe është në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2017 . Xhamia është djegur gjatë luftës së fundit në vitin 1999, me ç’rast ka shpëtuar vetëm minarja.